



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 21804

Më: 25 shkurt 2025

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 25 shkurt 2025 në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:08 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Naxhije Memaj Florent Ukaj, Egzona Hoxhaj, Levent Buş dhe Bajram Kastrati, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mungoi: Karanfil Haxhillari.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Ramize Shala Sinanaj nga DES, Shpresa Osmanollaj nga DUPH, Bexhat Bytyqi nga DBZHR, Ymer Berisha nga Zyra për Komunikim me Publikun, Halil Lika nga DEF Ertan Simitçi -Kryesues i Komitetit për Komunitete, përfaqësuesi i OSBE si dhe OJQ-të e Mediat.

Antigona Bytyqi: Atëherë përshëndetje dhe mirëse keni ardhur në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa, prezent jemi 8 anëtarë të KPF-së, kështu që mundemi me vazhduar me punën e kësaj mbledhjeje. Për sot për rend dite kemi këto pika:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 17 dhjetor 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimin për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm “Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit” sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, sipas kërkesës së MMPHI-së;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-planit për Vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e “Muzeut të Nënës Terezë” në Prizren;
7. Raporti financiar për periudhën tetor-dhjetor 2024;
8. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
9. Raporti vjetor për planin e Integritetit për vitin 2024;
10. Raportet e punës të Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2024:
 - Komitetit për Politike dhe Financa,
 - Komitetit për Komunitete.

Pika e parë;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të datës 17 dhjetor 2024;

Antigona Bytyqi: A ka dikush diçka me shtuar rreth procesverbalit? Ndonjë Koment, ndonjë vërejtje apo diçka? Nëqoftëse jo, po e hedhim në votim. Prezent jemi tetë anëtarë, kush është për që të miratohet? Unanimisht ju falenderoj të gjithëve. Kalojmë te shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.

Pika e dytë;

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

Antigona Bytyqi: Te rendi i ditës, a ka dikush diçka me shtuar? Po, drejtori e mandej edhe Dafina.

Bexhat bytyqi (Drejtor DBZHR): Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Ne në planifikimin e planit të kuvendit e kena futë që për muajin shkurt e kemi që të jetë pika e rendit të ditës për vlerësimin dhe shtimin e mjeteve për projektet të cilat janë në Drejtorinë Bujqësisë për pjesën e participimit me fermerë. Që mos të shkon në muajin mars, e kena pa të arsyeshme që me e propozu, nuk është diçka që edhe te ju ndikon. Kjo është mirë që të futet sa më herët, projektet mi tenderu edhe shpresojmë që shumë më herët sivjet t'i realizojmë këto projekte. Që mos të na vonohet ligjshmëria dhe procedurat tjera, materialet i kena gati, nëse e shihni të arsyeshme me e futë pikë të rendit të ditës.

Antigona Bytyqi: A i keni shpërnda materialet?

Bexhat bytyqi (Drejtor DBZHR): Jo, materialin gati e kemi, po e shpërndajmë.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtor për propozimin. Dafina urdhëro.

Dafina Alishani: Unë e kam një propozim me e futë në rend dite: Diskutim për subvencionimit të dëmeve të shkaktuara në natën e vitit të ri këtu në lagjen bazhdarhane. Kemi pranuar ankesa prej atyre të dëmtuarve që ende nuk ka informata, as vlerësim të dëmit, as ndonjë përgjegje në lidhje me sa ka mu mbulu dëmi atje. Mire është me u diskutu në kuvend, për shkak që kemi qenë me një vakum të pushimeve edhe festive. Aty dikush është dëmtuar edhe mendoj që ne si legjislativ së paku do të duhej që ta diskutojmë edhe ta gjejmë një mënyrë të mbështetjes financiare, qoftë me Drejtorinë e Emergjencave, qoftë me ndonjë drejtor tjetër si për meremetim të atyre objekteve që janë. Unë kam pritur së paku që edhe Urbanizmi edhe Drejtoria e Shërbimeve Publike do të ishin shumë më active për me ja mbulu atë dëmin aty. Edhe me mbetë kështu një muaj e gjysmë, çfarë një muaj, dy muaj pa përgjegje! mendoj që është e padrejtë për ata banorët atje. Le ta diskutojmë, le të jenë mediat prezent, le të jenë asambleistat prezent edhe ta shohim se ku ka mrri procesi. Domethë është diskutim dhe subvencionim i dëmeve.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Dafina. Diskutim për subvencionim, por e emërtojmë mandej. Dikush tjetër a kemi? Atëher u dhanë dy propozime, po shkojmë me propozimin e parë drejtori që e dha. Kush është për që të hyj në rend dite? Unanimisht, ju faleminderit. Për pike e dytë të propozuar nga Dafina? Unanimisht, ju faleminderit. Atëher 1% rendin e ditës në tërësi me dy pikat e reja po e hedhim në rendin e ditës në tërësi me dy pikat e reja po e hedhim në votim. Kush është që të miratohet rendi i ditës? Unanimisht, ju faleminderit. Drejtor mduket pate me shut diçka?

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): po, unë kam takim, nëse bënë me e prezentu këtë pikë të rendit të ditës dhe me më liru, nëse është e mundshme, nëse jo pres.

Egzona Hoxhaj: Ashtu ashtu, e diskutojmë prapë në seancë.

Antigona Bytyqi: A keni nevojë diçka me Sqaru?

Dafina Alishani: Drejtor, veç most ë jetë na tani me vepru, me marrë vendim edhe mandej me thënë s'ka mjete, ose jemi pa pare, çka i shërben qeky vendim?

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Tash sipas ligjit të ri, asambleja merr vendim për pjesën participimit të fermerëve. Domethënë përqindja, ne vetëm atë pjesë duhet me caktu. Shkurt po e përmbylli dhe elaboroj pak, ne si drejtori e kena paraparë të arsyeshme që diku 20% të jetë pjesa e participimit të fermerëve. Po na duket shumë e arsyeshme me qenë kjo për arsye se nuk i japim mundësi edhe fermerëve shumë të vegjël edhe me hy sepse me një participim shumë të vogël, përgjegjësia është shumë e vogël edhe fermerit ndaj paisjeve që po i merrë. Unë kisha kërkuar prej juve që këtë 20%-shin mos me e ulë. Jo që nuk ka mjete, na kena mjete edhe pa participim me e kry krejt, por është qështja që nuk ka seriozitet fermeri ndaj paisjeve që i merr. Për me arritë atë seriozitet është mirë me përkrahë me këtë përqindje, mos mendoni që po bëhemi të mirë me fermerë ose me dikë pse po e ulim vlerën, por po e nënqojmë projektin.

Antigona Bytyqi: Në rregull drejtor, edhe në kuvend do ta diskutojmë. Por do t'u kisha lutur që edhe propozim-vendimin brenda ditës me na e dërgu, me na e bë gati në mënyrë që me ja u dërgu anëtarëve të kuvendit.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Po, ja u bëjmë gati. Pesë projekte i kena këtë vit që do t'i mbështesim prej bujqësisë për pjesën e participimit. Është: ngritja e pemishteve me pemë të imta, hapja e puseve për ujitjen e tokave bujqësore, furnizimi me mekanizëm bujqësorë, ngritja e serave dhe ngritja e pemishteve me pemë arvore. Këto pesë projekte do të jenë me participim, ne kemi paraparë 20%, tani do të jetë në dorën e juaj me propozu apo me vendos, d.m.th. asambleja e vendosë se sa do të jetë.

Dafina Alishani: Projektet nuk ndryshojnë apo?

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Jo jo, këto janë projekte që edhe me plan të prokurimit i kena edhe i kena tenderu.

Bajram Kastrati: A janë në bazë të kërkesave të fermerëve këto?

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Po

Bajram Kastrati: A ka me pas rritje të këtyre, po mendoj të numrit për shembull të mekanizmave?

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Jo, vlera është vlera është e përcaktuar 380 mijë euro është vlera e projektit, ne i kemi me i cekë, në formë tabelare ja u prezantojmë edhe atë ditë, e caktojmë edhe përqindjen, por vlera e projektit është 380 mijë euro,

Antigona Bytyqi: Ju kisha lutur që çkado që keni material me mi dërgu.

Bajram Kastrati: Te 20%shi drejtor, ne ndoshta me ty e kishim bënë një marrëveshje tash nëse na ngojnë edhe ata asambleistët e tjerë, ku me ditë, ka mundësi që ka me pasë propozime për përqindjen.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Nuk është problem.

Bajram Kastrati: Por jo shumë sikur herën e kaluar, sipas meje.

Dafina Alishani: Drejtor një pyetje, ju në vitin e kaluar keni, keni thënë së paku në kuvend që kanë me ndryshuar, nuk kanë me qenë të njëjtat linjat, për shembull blektorët tek çështja e deleve, jo pse familja ime mirret, por ka vite që kjo komunë nuk ka dhënë asnjë subvencion në lidhje me blegtorët ose a e din, duhet pak me qenë edhe ndryshim, çdo vjet ju me dhënë mekanizëm bujqësorë, nuk po më duket mua fort e logjikshme! Ose ke edhe domethënë blegtorë që merren edhe me kultivimin e lopëve se di sa kanë passa i përket pjesës së vektorëve të kryesisht prodhuesit me kultivimin e lopëve, se di sa kanë pasur.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Dafina, sa i përket pjesës së blegtorëve, kryesisht prodhuesve që merren me dele, ne çdo vit i subvencionojmë ata ka 5€ në kokë të deles, domethënë këto nuk hyjnë këtu, ato i subvencionojmë direkt, edhe vaksinimin kundër brucelozës ja kryejmë që në Kosovë nuk e kryen askush. Ndërsa te lopët insevinimin e bëjmë pa pagesë edhe vaksinimin, krejt i kanë.

Dafina Alishani: E njëjta çështje ka qenë vitin e kaluar edhe ju në kuvend keni thënë ky vit kështu le të vazhdon, ka pas kërkesa prej bujqëve dhe blegtorëve, vitin e ardhshëm kemi me ndryshuar disa linja në mënyrë që të jetë një farë gjithëpërfshirje.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Ne i kemi ndryshuar te mekanizmi bujqësor, nuk do të jenë mekanizmin bujqësor që kanë qenë vitin e kaluar, por kanë me qenë mekanizma bujqësor të tjerë, në atë aspekt po mendu unë që kena me i ndryshu edhe ato kanë qenë kërkesa. Ndërsa te blegtorët të jesh e binduar që asnjë drejtori në Republikën e Kosovës nuk i subvencionon më shumë se ne, të gjithë blektorët janë të subvencionuar nga 5€ në kokë të delës, i ka 100 dele ai merr një shumë të mjaftueshme, vaksinimin e ka pa pagesë, krejt asnjë shërbim veterinerët vetëm marrin pagesën prej neve, domethënë nuk paguan, fermeri nuk paguan fare.

Dafina Alishani: Po kanë shpenzime tjera.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Mbështetje jashtëzakonisht të madhe i kena bërë, janë diku 300.000€ shpenzime që kena bërë në këtë drejtim.

Antigona Bytyqi: Në qoftëse nuk ka edhe dikush tjetër.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Ndërsa atë që e kam thënë, unë e kam menduar se ka qenë kërkesa edhe disa asambleistëve aty edhe unë e kam potencu që ka me pas ndryshim në mekanizma bujqësore në atë aspekt ndryshim, jo të njëjta gjithmonë me i dhënë, sivjet ka ndryshim, ka pas ndryshim.

Bajram Kastrati: çka ka me pas ndryshim tash?

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Po ka me pas ndryshim, kena me dhënë pajisje të tjera, domethënë nuk kena me dhënë freza sikur viteve të tjera po ka pajisje të tjera, ka plluxh, mundet me pas grabuja. shumë gjëra të tjera që janë të nevojshme, pjatore, janë shumë projekte, domethënë mekanizma të tjerë.

Dafina Alishani: Edhe rekomandimi është mos me ulë përqindja apo? Se mirë e ka Bajrami në kuvend ka me qenë në Pazar.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Po nuk është mire, se shiko ju jeni asambleistë që shumë vite dhe i njihni domethënë edhe problematikat e bujqësisë edhe të fermerëve edhe të gjithëve, është mirë mos me ulë sepse unë kur t'i paguaj 20% e kam një përgjegjësi më të madhe të asaj pjese sesa mos me e pagu përqindjen, në atë aspekt është mirë me e ruajt, se mjete ka, për mjete nuk kena me pas problem.

Bajram Kastrati: E gjejmë një mesatare drejtor, jo me ulë shumë si herën e kalume.

Florent Ukaj: Unë më konkret po jam, nëse kam me pas golldona edhe kësaj here të jesh i bindur kanë me u kqepërdorë.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Nuk ka golldon.

Florent Ukaj: Se domethënë bujqit e vërtetë me golldona besoj që e kemi furnizuar shumicën.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Notokultivatorë të vegjël kam me pasë se ka kërkesë me kosë që janë të këtyre për me kositë.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtor, shihemi në kuvend për sqarime tjera.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Ju falënderoj të gjithëve dhe ju dëshiroj punë të mbarë, respekte.

Bajram Kastrati: Për respektin që e kemi, dy herë pa rend je.

Bexhat Bytyqi (Drejtor DBZHR): Edhe unë kam respekt për të gjithëve.

Antigona Bytyqi: Në kuvend është me rend, veç këtu pa rend. Atëherë po kalojmë te pika e tretë.

Pika e tretë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimin për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm “Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit” sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, sipas kërkesës së MMPHI-së;

Antigona Bytyqi: Zonja Shpresa edhe një sqarim pse na është kthyer përsëri?

Shpresa Osmanollaj (DUPH): Po faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Përsëri është kthyer, në fakt ministria e ka shtuar edhe nenin 8 që herën e kalume s’ka qenë, domethënë si dokumentacion në raport me ja bashkëngjit ministrisë. S’kam ndonjë koment tjetër përpos asaj që me u plotësu dokumentacioni i procedurave të shqyrtimit të publik i të gjitha procedurave, se në këtë rast është neni tetë cekët në nenin te të udhëzimit administrativ thuhet tetë ditë përpara të prezantohet njoftimi për shqyrtim publik, në dosjen e përpame njoftimi për hapjen e shqyrtimit

publik nuk ka qenë i bashkangjitur, kurse pjesa tjetër e dosjes është. Domethënë vetëm plotësim dokumentacioni.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, a keni ndonjë pyetje diçka?

Dafina Alishani: Çka tash e mbas?

Shpresa Osmanollaj (DUPH): Presim pra konfirmimin e ministrisë.

Dafina Alishani: Pastaj?

Bajram Kastrati: Pastaj gjashtë muaj.

Dafina Alishani: Shpesh na ka ardhur kjo pikë e rendit të ditës, unë në fushatë problemin më të madh e kam pasur me biznes që nuk kam dit me ja spjegu ku është problemi i zonës ekonomike?

Shpresa Osmanollaj (DUPH): Shiqo, tash herën e kalume për konfirmimin e ligjshmërisë është kërku procedura e shqyrtimit publik sipas udhëzimit administrativ edhe janë cekur para neni 12 paragrafi 1 2 3 4 5 6 7, e kjo është para kësaj, kurse e fundit është shtuar edhe neni 8, paragrafi 2 paragrafi 3, domethënë procedurat e hapjes së shqyrtimit public.

Dafina Alishani: Hala jemi te shqyrtimi public a?

Shpresa Osmanollaj (DUPH): Jo jo, shqyrtimi publik është përfunduar për konfirmim të ligjshmërisë së planit rregullativ kanë kërkuar dokumente shtesë të procedurave.

Dafina Alishani: Okej, kjo u përfundoj, çka na pret pas kësaj.

Shpresa Osmanollaj (DUPH): Mandej për produkturat i dini edhe ju formohen bord, formohet grupi i ekspertëve ato nuk janë pjesë të...

Dafina Alishani: Për dhënien në shfrytëzim. 15.14 min.

Shpresa: Ato nuk janë pjesë, unë flas për planin rregullues urban sepse jam menaxhere e projektit, kurse për procedurat e tjera nuk jam kompetent se ato janë procedura a shkojmë me partneritet publiko-privat a jo, nuk jam kompetente me fol. Unë veç mundem me diskutuar kështu.

Dafina Alishani: Levent, a ki naj informatë? Jo, seriozisht jam tepër e interesime çka na pret tash e mas.

Shpresa Osmanollaj(DUPH): Me gjasë duhet te formohet nje komision, një bord apo diçka që..

Levent Bus: formohet një komision apo bord edhe procedurat,

Dafina Alishani: Për dhënien në shfrytëzim?

Shpresa Osmanollaj (DUPH): Për menaxhim të kontratave etj, etj. apo qysh shkojnë procedurat. Unë muj veç kështu me dhënë të dhëna gjenerale sipas kontratave tjera që jam kanë.

Antigona Bytyqi: Po kjo ishte edhe përgjigja qytetarëve që ju kishit dhënë, që kanë kërkuar parcelat me sa e pashë në raport.

Shpresa Osmanollaj (DUPH): Po se i kemi në raport ato se edhe te na kanë kërku, po mandej ajo është procedurë që nuk i takon projektit, planit rregullues, këtu kemi të bëjmë vetëm me hartimin e planit rregullues dhe procedurat e hartimit të planit rregullues.

Dafina Alishani: Domethënë nëse edhe kjo përfundon, atëherë plani rregullues është i gatshëm.

Shpresa Osmanollaj (DUPH): Planit rregullues është i gatshëm edhe fillojnë procedurat mandej janë pjesë e lidërshpit.

Antigona Bytyqi: Dikush tjetër a keni diçka me shtuar? A keni ndonjë pyetje apo diçka? Atëherë po e hedhi në votim që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Kush është për? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e katërt.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi Draft-planit të punës së Kuvendit për vitin 2025.

Antigona Bytyqi: Po, siç e dini ne fillimisht e kemi formuar grupin punues për punimet e hartimit të planit të punës, ka pas ardhur ligjshmëria, konfirmi i ligjshmërisë që jemi në rregull, e kemi ftu grupin punues edhe e kemi bërë këtë draft të planit të punës së kuvendit, ndoshta më detajisht pak edhe në kuvend. A keni diçka me shtu ndonjë pikë, nëse jo këtu, e keni mundësinë edhe në kuvend. A keni diçka me shtuar? Në qoftëse jo, po e hedhi në votim. Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e pestë.

Pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-planit për vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për komunën e Prizrenit.

Antigona Bytyqi: Drejtoreshë fjala për juve.

Ramize Shala Sinanaj: Faleminderit kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Besoj që e keni marrë materialin, draft- planin për vlerësimin e rrezikut, është një dokument shumë voluminoz, është një dokument shumë i rëndësishëm për komunën e Prizrenit, është punuar një vit për me realizuar këtë plan, i kemi ndjek të gjitha procedurat ligjore, kemi marrë miratimin edhe prej AME-së për të cilin ky dokument veç është finalizuar, tash pritet veç me dalë dhe në në asamble me votuar dhe me marrë ligjshmërinë prej MAPL-së. Po ju tregoj se ky dokument i paraqet të gjitha pjesët të cilat paraqesin rrezikshmëri si nga vërshimet, si nga zjarret, si nga orteqet, si nga rëshqitjet edhe është një dokument që duhet patjetër me pas çdo komunë për arsye që nëse nuk e kemi si dokument mundemi me marrë edhe me gjobat prej AME-së.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtoreshë. A keni ndonjë pyetje diçka? Po Bajram urdhëro.

Bajram Kastrati: Unë po ndërliha me disa raste konkrete që keni pas drejtoreshë. Për shembull dëmtim, djegie e e shtëpisë kanë hasë në shumë telashe të dëmtuarit edhe s'kam mujt me lexu komplet me u bërë realist. Po cila është ajo ndihma që i jepet për shembull një të dëmtuari në rastin e djegies? Çfarë procedure duhet me ndjek ai person përveç vlerësimit, deri te dëmi? Do të thotë dëmshpërblimi përfundimtar i drejtorisë, edhe pse a ka mjete të mjaftueshme me ju përgjigj qytetarëve në këtë drejtim? I kam dy-tre raste konkrete ndoshta edhe pyetja s'po di a është e

përpiluar e saktë, Por po më intereson, nëse një i demtuar ka probleme, ka telashe, ju ka djegur shtëpia, pa marrë parasyshë cila është procedura deri në përfundim me ju përgjigj atij qytetari.

Ramize Shala Sinanaj: Bajram, kjo është një çështje krejt tjetër, kjo është një diçka tjetër. Kjo pyetja për të cilën ti po e bënë hiç nuk hyn te ky plan. Këtu i përcakton, këtu i përcakton zonat e rrezikshmërisë, nëse komuna do me ndërtuar një objekt me një pjesë, duhet me këqyr qet plan, qajo parcellë a është e rrezikuar prej vërshimeve, a është e rrezikume prej thatësirave, domethënë, qeky plan vetëm i përcakton zonat e rrezikshmëri. Ndërsa sa i përket zjarreve të shtëpive, kjo është një çështje individuale e një personi që i ndodh, nuk është pjesë e rrezikuar komplet, por atij i ka ndodhur për shkak të rrymës ose për shkak ku ta dimë ne për çfarë arsye është.

Bajram Kastrati: Këtu këtu po thotë dhe fatkeqësi të tjera në komunën e Prizrenit. Cilat janë ato fatkeqësi?

Ramize Shala Sinanaj: Fatkeqësi të tjera janë aksidentet..

Egzona Hoxhaj: A janë domethënë kjo që ka ndodhur për vitin e ri?

Ramize Shala Sinanaj: Po ama këtë që po e kërkon, tash pyetja është tjetër që po e kërkon Bajrami. Pcedura qysh duhet me i ndjekë? Fillimisht shkojnë zjarfikësit në teren, e dyta vjen inspektori.

Bajram Kastrati: Po drejtoreshë, por po thotë dhe fatkeqësitë tjera në komunën e Prizrenit.

Ramize Shala Sinanaj: Qeky aksidenti hyn qeky i vitit të ri. Për një shtëpi individuale veç kështu, është diçka tjetër, a po kupton? E qekjo si aksident që e ka përcaktuar si një mahallë qysh me thënë hyn qekjo. Dalin inspektorët e preventivës që janë në kuadër të AME-së, kemi dy inspektorë të cilët nuk na përgjigjen as neve si drejtori, as kryetari të komunës, por janë dy inspektorë që janë direkt nga AME-ja, në nivel të regjionit, jo vetëm për Prizrenin, Këta e bëjnë një raport, në bazë të raportit të atyre e bëjnë vlerësimin inspektorët edhe qet dëm që është shkaktuar e dërgojmë në AME. Ata prapë e kanë një komision tjetër ku e vërtetojnë raportin ose vlerësimin e këtyre inspektorëve, pastaj pas miratimit të tyre e dërgojnë në qeveri edhe rimbursohen. Kështu shkojnë këto llojet të aksidente.

Bajram Kastrati: Në çfarë përqindje rimbursohen?

Ramize Shala Sinanaj: N'varet prej dëmit që është shkaktuar, domethënë vijnë ekspertët.

Bajram Kastrati: A ka të detalizuar këtu diçka?

Ramize Shala Sinanaj: N'varet, i kanë edhe çmimet e tregut, për shembull i kanë sa mundet me kushtuar një dritare, sa mundet me kushtuar një derë, domethënë në basë të asaj e bëjnë vlerësimin e dëmit i cili i është shkaktuar atij objekti.

Adem Shabanaj: Tavan nuk ka si në rastet e shtëpive individuale, për shembull që e ka një tavan 1500€?

Ramize Shala Sinanaj: Jo jo, në këtë rast jo. A nëse digjet një shtëpi e kemi tavanin deri në 3000€ ne si komunë, ne si komunë e kemi për shtëpi individuale deri në 3000€, ndërsa për biznese deri në 5000€. Kështu është rregullorja, po në këtë pjesën...

Bajram Kastrati: Pa marrë parasysh shkaktari qysh ka ardhur, se ti po thua shtëpi individuale, por shkaktari mund nuk kanë krejt dikah tjetër.

Ramize Shala Sinanaj: Qeky komisioni e bënë atë vlerësim.

Dafina Alishani: Qeky dokument veç s'ka lidhje me atë që, kjo është për komunat kur ka me investuar dika me pas parasyshë.

Ramize Shala Sinanaj: Po zonat të cilat janë të rrezikume për mos me ndërtuar.

Dafina Alishani: Këqyre drejtoreshë, me gjithë respektin shumë punë e shkëlqyeshme qenka po ndoshta jeni të vetëdijshëm që komuna e Prizrenit bënë investime kapitale pa leje ndërtimore, ne kemi shkuar një hapje tutje me me i pasur edhe preventivat për fatkeqësitë ose me pasë, a e din si dosje, si dokument shumë e mirë, por në praktikë po dështojmë. Drejtorinë e Kulturës ti e ke me katër investime kapitale që unë personalisht kam hulumtuar dhe ka dalë që janë pa leje, e tash këto janë vetëm makijazhe që po bëjmë diçka. Jo për juve, por në praktikë kjo komunë ka dështuar në respektim të ligjit. E sa e sa ndërtime janë që ne nuk i dimë sepse nuk kemi mundur me i monitoruar, kjo është përgjegjësi e ekzekutivit.

Ramize Shala Sinanaj: Tash nëse më lejon me tu përgjig. Ne jemi komuna e dytë në Kosovë që e kemi qet raport, domethënë shumica e komunave të Kosovës nuk e kanë ende, tash kanë hy në proces, por ne jemi komuna e dytë, e para është komuna e Rahovecit që e ka këtë dokument, ne jemi komuna e dytë. Kemi pas takime me AME-në me të gjithë drejtorët e emergjencave edhe ata na kanë obliguar se nëse nuk kemi me e pas këtë dokument. domethënë kanë me pasuar gjobat për secilën komunë. Kështu që ne jemi komuna e dytë në nivel të Kosovës që e kemi këtë dokument. Rahoveci e ka marrë ligjshmërinë, ne jemi komuna e dytë, ndërsa komunat të tjerat janë në procedurë e sipër. Kështu që po të garantoj që..

Bajram Kastrati: A mundem edhe një pyetje konkrete. Është tensioni i lartë, se di qysh e emërtojnë këta të KEDS-it, 52 a 92 se di qysh e kanë njëfarë emërtimi që i bie përmes qytetit shumë. A është paraparë si..?

Ramize Shala Sinanaj: Nëse e keni vërejtë aty e kemi në rregull tash veç, në komisione të gjithë institucionet e kanë tani anga një nëtarë të komisionit, e kështu që për më detajisht atë ditë kur ta bëjë prezantimin ai që ka me prezantuar këtë planin është më mirë me bë pyetje.

Bajram Kastrati: Në seancë apo?

Ramize Shala Sinanaj: Po ka me qenë në seancë edhe keni me bë pyetje, se ndoshta dhe mundem me ju dhënë diçka përgjigje të gabuar sepse nuk jam eksperte e kësaj fushes. Përndryshe aty në vendim janë prej secilit institucion janë nga një anëtar në komision.

Bajram Kastrati: Faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. A ka dikush tjetër? Në qoftë se jo, po e hedhi në votim edhe pikën e pestë që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Kush është për? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e gjashtë,

Pika e gjashtë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut të Nënës Terezë në Prizren.

Antigona Bytyqi: Materialin e keni, edhe një propozim-vendim edhe e kemi Blerimin këtu po më duket je në grup punues apo?

Blerim Rakaj: Përshëndetje për të gjithë. Po, një sqarim, jemi në grup punues për hartimin e statutit, është një grup punues prej OJQ-ve, zyrtar të Ministrisë së Kulturës edhe ekspertë të tjerë, gjatë punës, ka lindur nevoja për aktin e themelimit të muzeut fillimisht, mandej me vazhduar me procedurat e hartit të statutit. Propozim-vendimin e kemi dërguar dhe për sugjerime në Ministrinë së Kulturës, ato na kanë sugjeruar që duhet me heq Ligjin për Artin dhe Kulturën nga preambula, ka propozuar Sekretari i Ministrisë, e kemi bërë në propozim ndryshimin, i njëjti do t'ju shkojë edhe kuventarëve. Vetëm në preambulë janë ndryshimet, të tjerat janë njëjtë.

Antigona Bytyqi: Dje na ka ardhë qekjo e-mail apo, a e keni këtë ndryshimin?

Blerim Rakaj: E-mail janë më shumë komunikim i brendshëm, po e kanë të bashkangjitur, faqja e parë është ndryshimi, faqja e dytë i kalumi.

Antigona Bytyqi: Po, po thotë të hiqet nga preambula meqë fushveprimi i tij nuk përfshinë, do të thotë propozimin e keni në rregull, veç me heq.

Blerim Rakaj: Ja dërgojmë propozimin-vendimin e ri me ndryshime kuvendarëve.

Dafina Alishani: Muzeu është hapur.

Blerim Rakaj: është një marrëveshje trevjeçare bashkëpunimi mes komunës me CHWB-në.

Dafina Alishani: po veç Muzeun ne e kena bë për hajër, tash me hap njëherë pastaj me ardhë themelimi i muzeut po më duket pak!

Blerim Rakaj: Ato pjesët tjera unë si di qysh.

Dafina Alishani: Edhe mediat kanë qenë atë ditë edhe a e din kjo është pak edhe qysh mungesë e respektit ndaj legjislativit Kryesuese. Ne i bëjmë punët tona, i hapim, i mbyllim, pastaj e shohim se çka bënë legjislativi, është mungesë e respektit totalisht nga DKRS-ja kundrejt legjislativit, është për të ardhur keq. Domethënë ne jemi këtu vetëm mekanizëm që voton kështu me automatizëm, as nuk vetet, as nuk respektohet.

Blerim Rakaj: Nëse mundem qysh është diskutuar së paku në grup punues. Ata kanë me vepruar në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi me afat tre vjeçar, gjatë kësaj kohe me i përgatit infrastrukturën si statut e krejt këto aktet ligjore.

Dafina Alishani: Në rregull jemi, por nuk është në rregull me hap Muzeun dhe pastaj me ardhur propozim-vendimi për themelimin e Muzeut.

Blerim Rakaj: Ndoshta kanë vepruar duke u bazu në atë marrëveshje, s'po di.

Antigona Bytyqi: Po s'po di qysh e kanë pasë, meqë edhe ministria është, edhe është organizata.

Dafina Alishani: Në rregull, por me procedurë nuk jemi në rregull se është shumë me rëndësi ligjërisht me u aktivizu e gjitha edhe me pas një muze shtesë në komunën tonë po jo bash qeshtu. Me përbuz një legjislativ komplet, ku është drejtori Adem Morina?

Antigona Bytyqi: A keni diçka tjetër? nëse jo po e hedhi në votim. Kush është që ti rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e shtatë.

Pika e shtatë:

Raporti financiar për periudhën tetor-dhjetor 2024.

Antigona Bytyqi: Po zotëri Lika, fjala për juve.

Halil Lika (DEF): Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Për shpenzime domethënë tetor-dhjetor ka qenë në total 20,786.192, me përqindja 29.08. A ka nevojë ta lexoj?

Egzona Hoxhaj: Kryesuese, ndoshta është mirë për shkak që jo veç për neve, por në kuvend jemi krejt edhe ndoshta këto raporte është mirë me u dhënë detaje më të mëdhaja në kuvend që puna edhe për këta mos me u bë shumë e lodhshme, me i lënë raportet krejt veç në kuvend me u raportu. Jemi prezent edhe na edhe pjesa tjetër e asambleistave, propozimi jem.

Antigona Bytyqi: Tash shumica qysh të thojnë.

Egzona Hoxhaj: Se tash krejt raporte rend i kena.

Bajram Kastrati: çka propozove se nuk të kuptova?

Egzona Hoxhaj: Mos me u raportu këtu te ne sepse i kemi materialet. Qekjo finansiari, i Kuvendit, rrafsh që s'di sa KPF-ja janë tuj ardhë dhe i kena diskutu.

Dafina Alishani: Saherë që është rekomanduar raportimi më i detajizuar në kuvend, kanë dalë zyrtarët kanë thënë besoj që e keni lexuar raportin, andaj nëse keni pyetje vazhdojmë.

Egzona Hoxhaj: Njëjtë mundet me thënë edhe në KPF pra, nëse s'është i përgatitur për me na raportuar në kuvend.

Dafina Alishani: Këto raportet jo pa kast, me kast po kalohen shumë shpejtë.

Egzona Hoxhaj: Problemi është që ndoshta në seancë nuk po rrijna na me i ngu për atë.

Adem Shabanaj: Zyrtari është tuj pritë a po lejoni a s'po lejoni.

Egzona Hoxhaj: Tash vendosni ju, unë e dhash propozimin me lanë për seancë.

Dafina Alishani: Zyrtari a mundet me na tregu suficiti sa ka qenë, mundet me na tregu..

Halil Lika (DEF): Ende është në përgatitje domethënë, nuk është shumë, sa e di tash këtu se kemi.

Dafina Alishani: Mundet me na tregu borxhet ndaj operatorëve ekonomik sa është, se ka shumë ankesa që janë kryer shumë punë me premtime që veç vazhdoni edhe ju paguajmë edhe tash miliona kanë mbet pa pagu.

Halil Lika (DEF): ai vit që mbyllet domethënë është ne përpunim e sipër, tash ka qenë i mbyllur në mars domethënë..

Dafina Alishani: është mirë me na treguar për subvencionet?

Halil Lika (DEF): Mirë është me kërk se këtu vetëm përfshihen shpenzimet që janë bërë a këto të tjera domethënë komplet raporti do të jetë i gatshëm domethënë me siguri kanë me ja u dërgu juve se sa janë domethënë suficit edhe sa janë obligimet që kanë mbetur.

Dafina Alishani: Po ju a jeni zyrtar financiar?

Halil Lika (DEF): Unë jam zyrtar i lartë për menaxhim financiar, por ZKF-ja është ai që domethënë i përmbledh të gjitha shënimet. Kështu që për momentin nuk e kemi këtu atë, por për ato mendoj domethënë edhe ajo do të raportohet në siguri në mars. Në qoftë se keni nevojë ne mund t'ju dërgojmë edhe juve si informa.

Dafina Alishani: Dua me ditë subvencionet a janë paguar Prej Drejtorisë së Turizmit edhe DKRS-së? Sa prej OJQ-ve kanë pranuar pagesa? Sa nuk kanë pranuar? Të gjithëve ju kanë thënë që në janar në vitin 2025 ju paguhen, a janë paguar? jemi në fund të shkurtit.

Halil Lika (DEF): Po tani ishte 300 mijë euro që janë bërë pagesat, janë shpërndarë edhe turizmit edhe sociale, kulturës edhe shëndetësisë.

Dafina Alishani: Mirë është ato me i ditë, suficitin mirë është me e ditë, cilat drejtori kanë shpenzuar sa përqindëshin e investimeve.

Halil Lika (DEF): Këtu po mendoj përqindja tash është vetëm tre mujori, përndryshe domethënë duhet me pas komplet, unë erdha vetëm për shpenzime tetor-dhjetor. Por këtë po e shënoj unë, subvencionet dhe suficitit edhe domethënë normal ajo dihet pastaj si janë shpenzuar për shembull këtu vetëm është ndarë sipas drejtorive se janë shpenzuar për tre muaj të investimeve kapitale sipas drejtorive. Administrata 169.000 në buxhetin 248 mijë, shërbime publike 5 milion faktikisht total janë 8.782 mijë apo 34% të buxhetit. Kemi të hyra nga realizimi që është bërë për tre muaj 2 milion e 261 mijë, janë shpenzuar 22%. Por të tjerat domethënë i kemi sipas tre mujorit vetëm tani. Kjo do të raportohet pastaj vjen edhe radha që domethënë komplet viti si ka rrjedhë edhe sa kanë mbetur domethënë edhe suficit edhe subvencione sa kanë mbetur obligime edhe obligimet kapitale ndaj operatorëve.

Bajram Kastrati: Do të thotë në total 34.02%.

Halil Lika (DEF): Tash për tre mujorin vetëm po. Domethënë gjithsej ka qenë është 25 milion, vetëm për këtë tre muaj janë shpenzu afër 9 milion, totali me siguri kalon mbi 90%.

Antigona Bytyqi: A kemi diçka tjetër?

Dafina Alishani: Domethënë pavarësisht që është për tetor-dhjetor 2024, do të ishte mirë me dit si e kemi mbyll vitin edhe sa është borxhi ndaj operatorëve ekonomik? Kjo është një pasqyrë që duhet me e ditë ne për komunë.

Antigona Bytyqi: Atëherë po e hedhi në votim. Kush është që t'i rekomandohet mbledhjes? gjashtë jemi preznt, unanimsht, ju faleminderit.

Pika e tetë:

raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024;

Egzona Hoxhaj: Krejt njëjtë po shkojmë.

Antigona Bytyqi: Ani veç sa më shkurt, s'po di a po pajtohen krejt.

Egzona Hoxhaj: Tash Dafina a po pajtohemi, a po i lëmë për seancë?

Antigona Bytyqi: Tash është raporti i punës së kuvendit.

Dafina Alishani: Po bre veç po them mos të jetë tani me u keqpërdor me thënë besoj që e keni lexuar edhe, në rregull po vazhdojmë për seancë.

Antigona Bytyqi: Nëse doni edhe këtu më shumë.

Egzona Hoxhaj: Jo jo për krejt Kryesuese po e lëjmë për seancë.

Bajram Kastrati: Qysh ta vlerësojmë, për shembull për Ymerin se vlerësojnë për me shku.

Dafina Alishani: Ymerin dy herë me ngu është shumë.

Egzona Hoxhaj: Ok, Ymerin e ngojna në seancë, krejt i ngojna në seancë.

Antigona Bytyqi: Atëherë po e hedhim edhe pikën e tetë në votim. Kush është për që të rekomandohet? Unanimsht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e nëntë.

Pika e nëntë:

Raporti vjetor për planin e integritetit për vitin 2024,

Antigona Bytyqi: A po doni raport, apo në seancë?

Egzona Hoxhaj: Në seancë.

Antigona Bytyqi: Atëherë po e hedhim në votim. Unanimsht, faleminderit. Kalojmë te pika e dhjetë.

Pika e dhjetë:

Raportet e punës së komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës për vitin 2024,

- **Komiteti për Politikë dhe Financa dhe**
- **Komiteti për Komunikete.**

Antigona Bytyqi: Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Unanimisht, ju faleminderit. Propozimi që u bë nga drejtori e kemi.

Pika e njëmbëdhjetë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për lejimin e ndarjes së mjeteve në përqindje për projektet bashkëfinancim me fermerë në Komunën se Prizrenit;

Antigona Bytyqi: Kush është për? Unanimisht, ju faleminderit. Edhe propozimi që u dha nga Dafina.

Pika e dymbëdhjetë:

Diskutim për mundësinë e subvencionimit të dëmit të shkaktuar nga fishekzjarrët në fund vit.

Antigona Bytyqi: Urdhëro Bajram.

Bajram Kastrati: Me i bë pyetje Dafinës si propozues të na japin detaje e propozimit.

Dafina Alishani: Detajet ishte dashur Drejtoria e Emergjencave me na raportu më së pari vlerën e dëmeve, pastaj me raportu qysh domethënë aty disa objekte banimi.

Bajram Kastrati: Duhet me obligu Drejtorinë e Emergjencëve, me kanë prezent në këtë pike.

Egzona Hoxhaj: është e ka atë rregulloren.

Dafina Alishani: Qytetarët kanë bërë kërkesë në komunë, kanë bërë kërkesë edhe te zyra e kryetarit edhe te drejtoritë përkatëse për subvencionim apo mbulimin e shpenzimeve që ju kanë bërë. Tash një lokal është rikthyer, i ka bërë vetë me shpenzimet e veta, kanë investu. Por objekti i banimit për shembull ende pret mëshirën e komunës. Duhet me na raportu drejtoritë përkatëse mendoj.

Antigona Bytyqi: Ju falenderoj për pjesëmarrje dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Përfundoi në ora: 10:56 minuta.


Kryesuesja e KPF-së
Antigona Bytyqi